

Ndër poetët e para-revolucionit bolshevik rus, mes tjerëve, Osip Mandelshtami (1891-1938) tërheq vëmendjen për çiltërsinë dhe tematikat e krijimtarisë së tij letrare si edhe për vargënimin. Ishte mjaft i ri kur e ama e mori dhe e çoi te Majakovski, autoriteti i të cilit ishte i padiskutueshëm, ndonëse dy vjet ma i ri se Osipi.

Majakovski u prek sa prej vargjeve, aq edhe prej syve të djaloshit që dukeshin se po i luteshin. E ama e pyeti: “Si mendoni? A mund të shkruiej vargje apo të merret me tregti ma mirë?” por Majakovski iu përgjegi se djali dinte me shkruje mjaft hijshëm. Miqësia mes Majakovskit dhe Mandelshtamit u forcua ma tej, ma vonë, veçanërisht mbas revolucionit bolshevik të cilin shumica e poetëve të Shekullit të Argjendë, siç quheshin, e kishin mirëpritë ma shumë nga ç’e kishin kuptue.

Kështu, në 1919, të dy lexonin vargjet e veta te bar-kafeja H.L.A.M. (shkurtim i “hudozhniki, literatori, artisti, muzikanti”) në Kiev. Kishin ardhë këtu të gjithë artistët ma të njohun të Bashkimit Sovjetik pse në Kiev zija e bukës që kishte mbërthye vendin nuk ndjehej sa në Moskë dhe në Leningrad.

Asht interesante një dëshmi për autoritetin e padiskutueshëm që gëzonte Majakovski qysh në atë kohë. Në hymje të H.L.A.M.-it lexohet: “Kur të hysh këtu, hiqe kapelën pse brenda mund të jetë ulun Majakovski!”.

Pikërisht te ky vend argëtimi, më 1 maj 1919, u takuen Osip Mandelshtami dhe Nadezhda, bashkëshortja e tij e ardhshme.

Osip Mandelshtami kishte lé në Varshavë, në një familje tregtarësh hebrenj spanjollë. Ma vonë familja e tij u shpërngul në Shën Pjetërburg e këtu, në 1910-1911, poeti i ardhshëm filloi me frekuentue rrethin letrar, religjоз dhe filozofik që mblidhej në pallatin me kullë të Vjaçeslav Ivanovit (*Ivanova bashnja*, shqip: “kulla e Ivanovit”). Antarë të këtij rrethi ishin intelektualët Nikollaj Berdjajev, Dmitri Merezhkovskij, Dmitri Fillosofov etj. Aty vinte edhe Anna Ahmatova dhe i shoqi Nikolaj Gumiljov, me të cilët Mandelshtami njihej që në kohët kur kishte studjue në Francë.

Intelektualët që takoheshin në “Kullën e Ivanovit”, ishin ithtarë të simbolizmit, që ma tepër se rrymë letrare shihej si një sekt me rregulla tepër shtrënguese. Pikërisht, si kundërpërgjegje, Nikollaj Gumiljovi, Anna Ahmatova, Osip Mandelshtami e të tjerë, u shkëputën dhe themeluen “akmeizmin”, një tjetër lëvizje letrare që kishte si parim “kulmin e qartësisë” në të shprehun dhe shmangien e figurave letrare.

Asht shumë i veçantë përshkrimi që Lidija Ginzburg i ban Mandelshtamit

të asaj kohe: “I mungonte ajo çka ka shumica e perëndimorëve dhe një pjesë e rusëve – distanca ndërmjet impulsit [mendor] dhe veprimit.” Ky përshkrim i Ginzburgut, ndoshta, shpjegon pse Mandelshtami qeshte aq fort dhe pa kalue as edhe një çast binte në një depresion të thellë.

Mbas martese, Nadezhda e ndoqi kudo Osjan – siç e quenin miqtë Mandelshtamin – dhe nuk e braktisi asnjëherë. Persekutimi i tyne qe i gjatë, zuni fill kur poeti ishte gjallë e nuk mbaroi deri mbas ardhjes në pushtet të Hrushovit.

Dy arrestimet dhe vdekja e poetit

Në natën mes 13 dhe 14 maj 1934, Mandelshtami arrestohet për herë të parë. NKVD kërkonte poezitë e tija të fundit. Atë natë gjendej aty, si bujtëse, edhe Anna Ahmatova, por në shtëpi nuk kishin asnjë ushqim. Osipi iu kërkoi fqinjëve diçka me ngranë dhe u kthye në shtëpi me një vezë në dorë. Në orën një mbas mesnate ra zilja dhe Nadezhda tha: “Po vijnë me marrë Osipin!” Kur hynë brenda punonjësit e sigurimit, i gjetën mes tjerash edhe vjershën “Ujk”. Oficeri e lexoi atypëraty e ngaqë s’e kuptoi, pyeti poetin: “Po kjo, ç’asht?” Poeti nuk i dha shpjegime por vetëm u përgjegj me za të ultë: “Eh, po! Ç’asht!”

Para se me e marrë, Anna Ahmatova iu lut të hante vezën që ai vetë kishte marrë te fqinjët. Mbasi e hangri, Osipi mori një botim doracak të “Komedisë hyjnore” të Alighierit, e futi në xhep dhe shkoi me oficerët e sigurimit.

Dy javë mbas arrestimit, Nadezhda mori një ftesë tepër të çuditshme – hetuesi i kërkonte me ardhë me pa në burg të shoqin. Nadezhda shkon dhe tronditet prej asaj që sheh e dëgjon. Përpara, në koridor, krejt papritmas, ndeshet në disa roje që shoqnojnë një kinez të gjatë, me sy të zgurdulluem. I mbante pantallonat me dorë se mos i binin. Çoroditen si rojet, që nuk pritshin se aty mund të kalonte një grue, ashtu edhe Nadezhda. Kur hyn në takim me Mandelshtamin vëren se edhe ky i mban pantallonat me dorë. Profilaktika e burgut kishte si qëllim shmangien e vetvrasjes të të arrestuemve. Gjatë takimit, Mandelshtami e pyet se e kujt asht paltoja që Nadezhda ka veshë. “E nanës.” – përgjegjet grueja. “Po, kur ka ardhë?”. Nadezhda i përgjegjet e ai vazhdon: “Domethanë, ti ke qenë në shtëpi gjatë gjithë kësaj kohe?” Nga kjo bisedë disi e çuditëshme, e shoqja kupton se Osipit gjatë hetuesisë i kishin thanë se edhe ajo gjendej e arrestueme.

Gjyqi e dënoi Mandelshtamin me tri vjet internim në Çerdëjn, por mbas ndërhyrjeve të vazhdueshme të Ahmatovës dhe të Pasternakut, e çuen në Voronezh. Pak ma vonë, në Voronezh, në internim me të, shkoi edhe Nadezhda. Aty pati mundësinë me pa si i shkruente vargjet i shoqi: i binte tamthit si një zhytës që nxjerrë ujin prej veshit ngaqë kështu i dukej se do të “lironte” fjalën e duhun për vargun që i nevojitej.

Për herë të dytë Osip Mandelshtami u arrestue me 2 maj 1938 dhe shkaku qe poezia “Ne jetojmë pa e ndie nën kambë vendin” , një akuzë e drejtëpërdrejtë kundër Stalinit. Kur ia kishte lexue këtë vjershë Pasternakut, ky i kishte shprehë mospajtimin e tij me këto fjalë: “Kjo që më lexuet nuk ka kurrëfarë lidhjeje me letërsinë, me poezinë. Nuk asht vepër letrare por një akt vetvrasjeje të cilin unë nuk e miratoj dhe në të cilin nuk due me marrë pjesë. Pra, ju nuk më keni lexue asgja, unë nuk kam dëgjue asgja, dhe, po ju lutem, mos ia lexoni askujt tjetër.”

Pikërisht, kjo poezi, siç e kishte parashikue Pasternaku, e çoi në një gropë të paemën më 27 dhjetor të atij viti, diku afër Vladivostokut. Nadezhdës iu kthye pakoja që i kishte dërgue me shenjimin: “Kthehet për arsye të vdekjes së marrësit.”

Pjesën tjetër të jetës, Nadezhda ia përkushtoi mbledhjes së vjershave të të shoqit përgjatë shtegtimeve të detyrueme të shumta që i ranë në hise. Ma në fund, në 1973, doli libri i parë me vjersha i Osip Mandelshtamit, por Nadezhda mbeti e zhgënjyeme jashtë mase – libri nuk ishte botue ashtu siç kishte dëshirue ajo.

Në të vërtetë, Mandelshtami, sikur të mos mjaftonin bindjet e tija politike, kishte dhanë dorëheqjen nga Lidhja e Shkrimtarëve të Bashkimit Sovjetik qysh në 1923 dhe ky veprim e kishte pengue vazhdimisht botimin e krijimeve të tija letrare.

* * *

Po i përcjellim lexuesit këtu, rusisht dhe shqip, dy poezitë që përmendëm ma sipër. Ndoshta, ma shumë se poezi, mund të quhen dokumente ose një letërnjoftim i mirëfilltë që dëshmon për identitetin e tij si individ dhe poet i patrandun edhe në kohën e spastrimeve staliniste.

Мы живем, под собою не чуя страны,

Наши речи за десять шагов не слышны,
А где хватит на полразговорца,
Там припомнят кремлёвского горца.
Его толстые пальцы, как черви, жирны,
А слова, как пудовые гири, верны,
Тараканы смеются усища,
И сияют его голенища.

Ne jetojmë pa e ndie nën kambë vendin

Ne jetojmë pa e ndie nën kambë vendin
bisedat tona nuk dëgjohen as dhjetë hapa përtej
Por aty ku flitet sadopak,
fill malokun e Kremlinit përmendin.
Gishtat e tij të trashë, si krymba, të lyrshëm
Kurse fjalët – si peshat e kandarit – të vërteta
Si brumbuj i qeshin mustakët
dhe i ndriçojnë qafat e çizmeve të zeza

А вокруг него сброд тонкошеих вождей,
Он играет услугами полулюдей.
Кто свистит, кто мяучит, кто хнычет,
Он один лишь бабачит и тычет,
Как подкову, кует за указом указ:

Кому в пах, кому в лоб, кому в бровь, кому
в глаз.

Что ни казнь у него - то малина

И широкая грудь осетина.

(Ноябрь 1933)

Волк

За гремучую доблесть грядущих веков,
За высокое племя людей
Я лишился и чаши на пире отцов,
И веселья, и чести своей.
Мне на плечи кидается век-волкодав,
Но не волк я по крови своей,
Запихай меня лучше, как шапку, в рукав
Жаркой шубы сибирских степей, -
Чтоб не видеть ни труса, ни хлипкой
грязцы,
Ни кровавых костей в колесе,

Чтоб сияли всю ночь голубые песцы
Мне в своей первобытной красе.
Уведи меня в ночь, где течет Енисей,
И сосна до звезды достает,
Потому что не волк я по крови своей
И меня только равный убьет.

(1931)

Përqark tij një frohtë udhëheqësish qafëhollë
Ai luen me gjysmanjerëzit si me skllëvnit
dikush fishkëllen, mjaullinë, ose ofshanë
Vetëm ai gjëmon e drejton gishtin e randë
E si patkojt, rrahë një dekret mbas tjetrit:

Dikujt shpinës, dikujt ballit, dikujt vetullës ose
synit

çdo ndëshkim i tij – një dredhzhë [allit]

dhe gjoksi i gjanë i gjeorgjianit.

(Nandor 1933)

Ujk

Për lavdinë ushtuese të moteve që do të vijnë
Për fisin e naltë të njerëzimit
Unë bora edhe kupat në gòstën e etënve
edhe nderin tem, edhe gëzimin
Mbi shpatulla më hidhet një shekull-qenujk,
Por unë s'jam ujk, me gjak
Ma mirë më rras, si shapkën, brenda
mangës
së qyrkut të ngrohtë të stepave siberiane –
që të mos shoh as frikakët e as llumin,
as eshtnat e përgjakuna në rrotë.

Shëndrifshin gjithë natën dhelpnat kaltëroshe
për mue me bukurinë e zanafillës
Më çon natën aty ku rrjedh Enisej
Dhe çetina yjet prekë
Pse, me gjak, nuk jam ujk
Dhe vetëm një i barabartë do të më vrasë.

(1931)

Abstract

Born to Jewish parents, Osip Mandelshtam was one of the most prominent Russian poets from the Silver Age. Mandelshtam is not only known because of his verses but also because of his tragic end. When the NKVD, Stalin's secret service searched his flat in 1938– it was his second arrest – they found the poem *We live without sensing the country beneath us* which resulted in convicting him to imprisonment. A few months later the poet died in a gulag somewhere in Vladivostok and was thrown into a pit. Found during his first arrest in 1934, his other poem *Wolf* was no less original and powerful. In fact, it sounded like a conundrum to the police officer who came across it during the search.

Though famous, little is known about Osip Mandelshtam and his life and work in Albania, as he and his poems were banned not only in the URSS but in all former European socialist countries as well. However, these two poems have now been translated and any reader can have their say.